

Zgjerimi i Rrjetit Emerald në Ballkanin Perëndimor

Ballkani Perëndimor është një zonë globale e pasur me biodiversitet, veçanërisht për biodiversitetin e ujrave të ëmbla. Malet, lumenjtë dhe lagunat e këtij rajoni janë vendbanimi i shumë peshqve dhe llojeve të tjera akuatike që janë në rrezik zhdukje. Shumica prej tyre janë endemike – nuk gjehen në asnjë vend të botës. Një përqindje e lartë e lumenjve të këtij rajoni janë në gjendje të mirë ose të paprekur, e cila është mbi mesataren europiane.

Caktimi dhe menaxhimi i duhur i siteve të Rrjetit Emerald në Ballkanin Perëndimor mund të ofrojë mbrojtje dhe rikuperim për peshqit dhe llojet e tjera të rëndësishme dhe habitateve, duke ruajtur kështu vlerën unike të lumenjve të këtij rajoni. Si anëtarë të Këshillit të Europës dhe nënshkrues të Konventës së Bernës, pesë vendet e Ballkanit Perëndimor – Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia – janë të detyruara të vendosin një numër të mjaftueshëm të siteve Emerald por pak prej tyre janë propozuar deri më tani – të gjitha para vitit 2011.

Kjo hartë identifikon sitet më të rëndësishme për mbrojtjen e llojeve dhe habitateve të ujrave të ëmbla që duhet të shtohen në Rrjetin Emerald. Është rezultat i një përpjekje bashkëpunuese që përfshin 39 shkencëtarë dhe përfaqësues të OJQ-ve, duke përfshirë disa nga ekspertët kryesorë të peshqve në Evropë, të cilët iu bashkuan iniciativës Emerald Green në vitin 2022. Harta shoqërohet nga një bazë të dhënash me 88 segmente lumenjsh, duke ofruar informacion mbi llojet e peshqve të rëndësishëm europiane që jetojnë aty.

Zgjerimi i Rrjetit Esmerald është një hap i rëndësishëm drejt anëtarësimit në BE, kur sitet Emerald të bëhen kandidatë të siteve të Natura 2000. Ky proces do të sjellë më shumë përparësi për komunitetet që jetojnë përgjatë lumenjve, duke përfshirë aksesin për ujë të pijshëm dhe ushqim, ujë për vaditje, mbrojtje nga përmbytjet, rregullimin e klimës dhe mundësi për zhvillimin e peshkimit, sporteve ujorë dhe ekoturizmit, duke forcuar lidhjet midis vendeve.



Dobrica Mitrovic

Bosna në Bosnjë dhe Hercegovinë


Bosna është lumi më i madh që rrjedh në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ai gjithashtu është nga të paktët lumenjtë më të mëdhenj ballkanikë pa hidrocentrale ose diga të mëdha. Ekspertët kanë identifikuar 24 lloje të mbrojtura të peshkut në ujërat e tij, duke përfshirë llojin globalisht të rrezikuar të salmonit të Danubit (*Hucho hucho*), i cili mund të arrijë deri në 1.5 metra gjatësi.



Dobrica Mitrovic

Danubi në Serbi

Danubi, lumi më i madh në Ballkan, në shumicën e rrjedhjes së tij nëpër Serbi është kryesisht i pambrojtur. Ishujt e tij natyrorë, pyjet bregdetare dhe popullsitë e peshkut pa dyshim duhet të përfshihen në rrjetin "Emerald". Perka e Balonit (*Gymnocephalus baloni*), një lloj që është aktiv natën, jeton në zona ujore me rërë apo balte dhe ushqehet me organizma të vegjël invertebrorë.



Dejan Lazarevic

Zeta në Mal të Zi

Lumi Zeta në Mal të Zi është shpallur së fundmi Park Natyror, por ende nuk është një zonë Emerald. Ujërat e tij të ftohta strehojnë një nga popullsitë më të rëndësishme të troftës së mermertë (*Salmo marmoratus*) dhe troftës së Adriatikut (*Salmothymus obtusirostris* spp. *zetensis*) në Europë.



Mësoni më shumë rreth iniciativës Emerald Green, hartës, bazës së të dhënave dhe pjesëmarrësve:



Legjendë

- site të reja Emerald (lumenj dhe laguna)
- lumenj të tjerë
- site ekzistuese Emerald

Rajone biogeografike

- Panionian
- Kontinental
- Alpin
- Mesdhetar

Drini i Zi në Shqipëri

Kavalli i Drinit (*Eudontomyzon stankokaramani*) është endemike për lumin Drin. Në rrjedhën e sipërme të Drinit të Zi në Shqipëri gjenden disa nga popullatat më të rëndësishme të saj.



Andrey Raliev



Ayblige

Lumi Vardar në Maqedoninë e Veriut

Lumi Vardar dhe tributarët e tij janë vendbanimi i shumë llojeve të peshqve të mbrojtur. Më i rrezikuar është Mokra e Vardarit (*Zingel balcanicus*), i cili tani gjendet vetëm në Treska, një tributar i Vardarit në Maqedoninë e Veriut. Ai mund të zhduket për shkak të ndotjes, nxjerrjes së kripës dhe planifikimit të hidrocentralëve në zonat ku ai jeton.



Financuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura janë vetëm ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë ato të Bashkimit Evropian ose CINEA. Asnjëherë Bashkimi Evropian apo autoriteti grantdhënies nuk mund të mbajnë përgjegjësi për to.